

**Deri te:**

**Këshilli mësitor-shkencor i fakultetit Juridik**

## **VLERËSIM I KOMISIONIT MBI DISERTACIONIN E DOKTORATURËS**

Në bazë të vendimit nr.13-541/2 të datës 03.09.2020 të Këshillit mësitor-shkencor të fakultetit Juridik, për formimin e komisionit për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës, si dhe në bazë të nenit 62 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat për regjistrim dhe studim në ciklin e tretë të studimeve – studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës, komisioni në përbërje:

- 1. Prof. dr. Afrim Osmani, kryetar;**
- 2. Prof. dr. Bujar Ahmeti, anëtar**
- 3. Prof. dr. Fehari Ramadani, anëtar;**
- 4. Prof. dr. Jusuf Zejneli, anëtar;**
- 5. Prof. dr. Qebir Avziu, mentor.**

Pasi vlerësoj punimin e doktoraturës me temë “Përplasja e demokracive dhe autokracive në marrëdhëniet ndërkombëtare: Gjeopolitika Ideologjike dhe Civilo-centrizmi”, të kandidatit Mr.Sc. Gurakuç Kuçi, paraqet këtë:

### **R A P O R T**

**për vlerësimin e punimit të doktoraturës**

#### **1. Lënda e hulumtimit**

Studimi i marrëdhënieve ndërkombëtare nga aspekti shoqëror, politik dhe juridik ka qenë vazhdimisht pjesë e debateve të shumë teorive dhe koncepteve të cilat si disiplina në vete zakonisht kanë përjashtuar njëra-tjetrën. Këto përjashtime kanë prodhuar analiza të mangëta

të cilat kanë arritur të shpjegojnë apo prognozojnë rrethana vetëm nga një aspekt por në të rrallë kanë arritur t'ia gjejnë anën analizave dhe prognozave të sakta.

Nevoja për analiza më të sakta ka prodhuar studimet transdisiplinare në çdo lloj fushe duke përfshirë edhe shkencat sociale dhe juridike. Këto studime transdisiplinare në vetvete përfshijnë: epistemologjinë, ontologjinë, logjikën, aksiologjinë, juridikën, etj.

Nga fundi i Luftës së Parë Botërore e tutje studimet transdisiplinare kanë marrë një zhvillim shumë të madh, andaj edhe në temën e kandidatit për doktor, Mr. Sc. Gurakuç Kuçi janë përfshi studimet transdisiplinare në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare në tri fusha studimi:

- Fushën politike;
- Fushën shoqërore;
- Fushën juridike.

Në kuadër të këtyre tri fushave kandidati ka marrë tri koncepte të cilat janë *civilizimi, idelologjia dhe gjeopolitika* por që i ka trajtuar nga viti 1890 e tutje. Këtë prerje kandidati e ka bërë për dy arsye:

1. Deri me 1890 në Evropë kandidati argumenton se si ka sunduar aristokracia dhe politika e kabineteve. Me ardhjen në pushtet në Gjermani të Vilhelmit II dhe shkarkimit të Bizmarkut, nuk vazhdohet as Traktati i Risigurimit me Rusinë ku bënte pjesë edhe Austro-Hungaria dhe kjo e prish koncertin e balancave. Pas këtij viti shpërthen opinioni publik, nacionalizmi, shkenca dhe evoluimi i së drejtës ndërkombëtare.

2. Arsyja e dytë është krijimi i rrethanave të reja të cilat mundësuan daljen nga batakuri i politikave të mbyllura dhe vetëm Evropiane. Kjo hapje detyronte shtetet që të shikonin në formë më komplementare në ndërtimin e politikave. Fatkeqësia ishte sipas kandidatit që politika në nivel global filluan të parët të krijojnë nazistët, fashistët dhe militaristët, ndërsa të tjerët vetëm nga fundi i Luftës së Dytë Botërore.

Pas kësaj periudhe kandidati arrin të bëjë dallimin ndërmjet koalicioneve të cilat ndërtohen mbi afërsi si civilizimi dhe koalicionet vetëm mbi çështje të sigurisë. Lloji i parë, kandidati argumenton se janë më imperialist dhe lloji i dytë më shumë mbrojtës. Nga forma ideologjike ndarjet që kishin influencë të drejtpërdrejt në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare dalin pasi vijnë në pushtet nazizmi, fashizmi dhe militarizmi të cilat nga kandidati kategorizohen si ideologji përjashtuese (raciste, nacionaliste) dhe universaliste si



komunizmi dhe demokracia. Bazuar në këto dy lloj modele kandidati analizon gjeopolitikën e shteteve dhe ngjarjet deri pas Luftës së Dytë Botërore.

Pas Luftës së Dytë Botërore kur nga skena e politikës botërore mundën dhe largohen ideologjitë përjashtuese, atëherë bota mbetet në dy kampe me ideologji të kundërta por me qëllime universaliste. Këtu kandidati e gjen modelin e shpjegimit dhe analizimit të përpiktë trekonceptual të zhvillimeve ndërkombëtare. Për analizim më të saktë kandidati këtë periudhë e ndan në dy pjesë:

1. Periudha nga fundi i Luftës së Dytë Botërore deri me 1950. Kjo periudhë karakterizohet kryesisht kur dy kampet stabilizojnë fuqinë e tyre në zonat trekonceptuale dhe krijojnë sintezën e tyre të sigurisë, me sisteme unike ideologjike dhe në parim edhe juridike.
2. Pas kësaj periudhe atëherë kandidati argumenton se fillojnë përplasjet në zona jashtë trekonceptuale si ballafaqime të cilat largonin luftën nga kampet trekonceptuale dhe krijojnë rrihtë të rinj gjeopolitik për sigurinë regjionaliste civilizim, ideologji dhe gjeopolitikë. Për të analizuar dhe shpjeguar këtë periudhë më mirë, kandidati ka krijuar edhe një formulë ku ndahet në nivelin CIG (Civilizim, Ideologji, Gjeopolitikë), IG (Ideologji, Gjeopolitikë) dhe GP (Gjeopolitika Periferike) ku të gjitha këto krijojnë Gjeopolitikën Ideologjike dhe Civilo-centrizmin. Kjo periudhë karakterizohet më shumë ngjarje dhe rrethana të cilat i kanë dhënë brumë edhe zhvillimit të së drejtës ndërkombëtare të cilat kandidati i ka përfshirë në temë si pjesë e analizimit dhe shpjegimit trekonceptual.

Të gjitha këto kandidati i analizon si hapësirë që formësoi modelin e përplasjeve të reja pas Luftës së Ftohtë. Këto përplasje kandidati i shpjegon nga perspektiva politike dhe juridike si në rastin e Kosovës me intervenimin e NATO-së dhe vendimin e GjND-së për shpalljen e pavarësisë, rastin e shkëputjes së Krimesë dhe vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit në lidhje me Detin Jugor të Kinës.

## **2. Qëllimi i hulumtimit**

Qëllimi i hulumtimit në këtë temë të doktoraturës është prova e studimit të marrëdhënieve ndërkombëtare nga perspektiva e metodës transdisiplinare me tri koncepte (civilizimi, ideologjia dhe gjeopolitika) në formë komplementare. Kjo qasje ka për qëllim të japë rezultate më të sakta dhe prognoza më të përafërta të zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare si nga fusha politike ashtu edhe nga ajo juridike. Studimet transdisiplinare në periudhën nga fundi i Luftës së Ftohtë e

tutje po mundësojnë që studimet të jenë më ekíporë dhe më të sakta si brenda një shkence ashtu edhe ndërmjet shkencave. Kjo për pasojë po bënë që rezultatet të jenë më të sakta në një kohë ku dinamika e zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe e së drejtës ndërkombëtare është shumë e madhe dhe me zhvillime çdo ditë. Ky disertacion metodës transdisiplinare ia bënë edhe një provë historike duke e provuar atë edhe në periudha të mëhershme, pra nga 1890.

Sidoqoftë, nuk ka asnjë studim (të identifikuar të paktën) deri më tani të llojit të këtij disertacioni duke provuar analiza nëpërmjet tri koncepteve në formë komplementare. Ky lloj model studimi edhe pse brenda shkencave transdisiplinare ka një metodë të re komplementare të analizimit, shpjegimit dhe prognozimit.

Objekti i trajtimit të temës janë civilizimet të cilat përfaqësojnë superfuqi shtete bërthamë dhe civilizime të cilat po ndërtojnë një shtet bërthamë, ideologjitë të cilat ndahen në autoritare dhe demokratike dhe gjeopolitikën bazuar në teorinë e Rimland, Hinterland dhe atë të aviacionit apo ajrit. Këto lloj trajtime gjenden para një përplasje dhe bashkëpunimi edhe në hulumtime statistikore sipas indeksit të demokracisë të cilat statistika kandidati i ka marrë dhe përpunuar nga "The Economist Unit Intelligence".

Studimet transdisiplinare kanë dalë si mungesë e rezultateve të sakta nga studimet disiplinare por edhe si shfaqje e dinamikave të mëdha nga shumë aspekte të marrëdhënieve ndërkombëtare pas Luftës së Parë Botërore. Andaj edhe ky disertacion është në hapë me studimet transdisiplinare të cilat përfshijnë shpjegimin e:

- Realitetit,
- Subjektivitetit dhe
- Objektivitetit

Këto kanë për synim gjetjen e një mesazhi shpjegues të saktë të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe zbatimit të së drejtës ndërkombëtare, ku realiteti përfaqëson politikën, subjektiviteti e përfaqëson civilizimin dhe objektiviteti ideologjinë dhe ligjin.

### **3. Aplikimi i metodave shkencore**

*Veçimi i problemit:* Veçimi i problemit për të krijuar bazën studimore të vënë në titull kandidati e ka filluar duke vënë përplasjen e ideologjive pasi ato përplasje gjatë temës dhe historisë gjenden të ndara edhe në vija të civilizimit dhe kanë të bëjnë me përplasje ideologjike të ndryshme. Pasi në kuadër të sisteme autoritariste hyjnë edhe ato si komunizmi kjo e ka vënë



bazën *Përplasja e demokracive dhe autokracive në marrëdhëniet ndërkombëtare*. Kandidati për ta shpjeguar këtë lloj përplasje ka argumentuar se si nëpërmjet civilizimit dhe gjeopolitikës ashtu si me ideologjinë krijohet një civilo-centrizëm rreth një shteti bërthamë. Civilo-centrizmi sipas kandidatit fuqizohet nëpërmjet Gjeopolitikës Ideologjike duke shpjeguar përplasjet dhe kjo i jep kuptim titullit: *Përplasja e demokracive dhe autokracive në marrëdhëniet ndërkombëtare: gjeopolitika ideologjike dhe civilo-centrizmi*.

Kandidati po ashtu e ka bërë edhe veçimin e aktorëve përfaqësues të cilët duke pasur parasysh kush janë historikisht do i përmendim vetëm të fundit: SHBA-në, Kinën dhe Rusinë të cilët plotësojnë kriteret trekonceptuale dhe Turqinë me tendencën e saj për civilo-centrizëm islamik.

*Metoda e hulumtimit*: metoda e hulumtimit në punim është transdisiplinare bazuar në metodën e Basarab Nicolescut dhe shkollës së Cyrihut. Përdor edhe nivelet e analizës nga niveli i katërt i analizës (niveli global) me karakter të përzier me atë të tretë (regjional) gjë që për këtë kandidati në pjesën teorike ka zbërthyer modelin e teorisë së mesme. Hulumtimi përdor metodën transdisiplinare, krahasuese, analitike, statistikore dhe shpjeguese për të ardhur deri tek rezultatet.

Pyetja hulumtuese është: Si ndikojnë ideologjitë në shtrirjen e ndikimit të tyre gjeopolitik në zona të ndryshme të civilizimeve?

Hipoteza është: Civilizimi, Ideologjia dhe Gjeopolitika janë komplementare por jo në mënyrë paralele të përdorshme për shtrirje nga superfuqitë botërore (shtetet bërthamë) dhe si të tilla përdoren edhe nga shtetet tjera për tu ofruar me shtetet bërthamë për të krijuar sintezën e sigurisë, që sot krijojnë përplasjen ndërmjet demokracive dhe autokracive.

Ndërsa, variabli i varur është: Përplasja e regjimeve nëpërmjet gjeopolitikës ideologjike në zona civilo-centriste.

#### **4. Kontributi shkencor i hulumtimit**

Kandidati, Mr. Sc. Gurakuç Kuçi, duke pasur një temë e cila ka një trajtim transdisiplinare dhe komplementar trekonceptual, formë e re analitike dhe parashikuese ka kontribute shkencore të cilat në tërësi mund të kuptohen denjësisht vetëm nëse lexohet disertacioni në tërësi, megjithatë këtu do të përmendim disa kontribute.

Në marrëdhëniet ndërkombëtare ndikimi i ideologjisë dhe civilizimit nga studiuesit e kësaj fushe nuk shihen si koncepte që ndikojnë drejtpërdrejt e aq më pak si komplementare bashkë me gjeopolitikën. Mirëpo, nëse shohim argumentimin e kandidatit bazuar në metodën transdisiplinare e kuptojmë që analizimi dhe parashikimi i marrëdhënieve ndërkombëtare pashmangshëm duhet të shihet nga shumë anë që të ketë saktësi. Kontributi kryesor i kandidatit është që arrin të argumentoj se si civilizimi, ideologjia dhe gjeopolitika janë tri koncepte që funksionojnë në formë paralele dhe jo-paralele për analizimin dhe parashikimin e zhvillimeve ndërkombëtare nga forma politike dhe juridike.

Kontribut tjetër nga kandidati është argumentimi nga ana juridike e disa rrethanave dhe ngjarjeve në arenën ndërkombëtare nëpërmjet trekonceptualitetit gjë që tregon se e drejta ndërkombëtare është një element që vepron në duart e fuqive të mëdha dhe nuk reagohet kur prek zonat trekonceptuale të njëri-tjetrit edhe nëse shkelet e drejta ndërkombëtare.

Kandidati gjithashtu me këtë temë ka arritur të ofrojë për shkencën një model të ndarjes së ideologjive me kritere si civilizimi, kultura, nacionalizmi e racizmi duke e bërë kështu ideologjinë si një proces komplementar me civilizimin dhe të dyja këto për ta ruajtur zonën e tyre bëhen komplementar me gjeopolitikën.

Ky lloj trekonceptualiteti tregon edhe format e shtrirjeve juridike të cilat janë zbatuar në zona të ndryshme trekonceptuale dhe si kontribut jep se pse një formë e caktuar juridike dhe të drejta të caktuara mund të funksionojnë në një zonë trekonceptuale dhe jo në një tjetër.

Kontribut tjetër i kandidatit është opsioni i bashkëpunimit dhe përplasjes duke pranuar qenësinë reale të zonave globale. Kjo mundëson që nëpërmjet analizës trekonceptuale të ofrohet një lloj analize dhe strategjie për fuqitë e mëdha se ku mund të bashkëpunojnë dhe të shmangin përplasjet për shkak të moskomplementaritetit trekonceptual, shembull si në rastin e SHBA-së me Irakun apo Afganistanin.

## **5. Fusha shkencore e hulumtimit**

Disertacioni i kandidatit, Mr. Sc, Gurakuç Kuçi, ka një aplikueshmëri të gjerë përdorimi nga palë të tjera. Punimi i kandidatit është i punuar nga sfera e politikës ndërkombëtare dhe e së drejtës ndërkombëtare. Kandidati sipas nevojës ka përdorur katër nivelet e analizës së marrëdhënieve ndërkombëtare (nivelelin shtetëror, rajonal, inter-rajonale dhe globale).



Ndërsa aplikueshmëria e disertacionit të z. Kuçi mund të përdoret në të gjitha sferat sociale, ekonomike dhe juridike në fushën ndërkombëtare si një temë që më shumë promovon gjetjen e modeleve të bashkëpunimit nëpërmjet analizave komplementare se sa përplasjen apo pushtimin.

## **6. Rezultatet e hulumtimit**

Punimi vazhdimisht nxjerr rezultate nga perspektiva transdisiplinare e tri koncepteve në formë paralele dhe jo paralele trikonceptuale.

Në hyrje të punimit është argumentuar në mënyrë shkencore dhe pragmatike se si shekulli XIX deri me 1890 ka qenë një sundim i politikës së kabineteve dhe aristokracisë përkundër ndryshimeve që kishte sjellur Revolucioni Francez dhe se kjo periudhë njih koalicione edhe kundër ndryshimeve politike e sociale. Po ashtu në këtë pjesë argumentohet se si pas 1890 kur edhe priset 'Koncerti i Evropës' në shesh dalin formacione të reja politike, nacionalizmi, ideologji të ndryshme, rritet alfabetizimi dhe ndikimi i opinionit publik, gjithashtu se në këtë periudhë pikërisht fillojnë të dalin dhe zbatohen teori mbi ideologjinë, civilizimin dhe gjeopolitikën.

Në kapitullin e parë janë bërë shqyrtimet teorike të të tria koncepteve veç e veç dhe është gjetur komplementariteti i tri koncepteve. Por para se këto koncepte të shqyrtohen, kandidati ka formuar edhe qasjen teorike ku ndërmjet të përgjithshmes së Eastonit dhe të veçantës së Poperit, ka zgjedhur atë të mesmen e Fukuyamës dhe transdisiplinaren e shkollës së Cyrihut dhe Basarab Nicollescut. Këtu kandidati bind me argumente se të tri konceptet në realitet kanë një ndërvarshmëri dhe mes për analizimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe shpjegimin e zbatimit të së drejtës ndërkombëtare.

Në kapitullin e dytë kandidati ka shpjeguar metodat e hulumtimit të cilat janë cekur edhe më lartë.

Kapitulli i tretë përfshin periudhën nga 1890 deri me 1945, apo nga rënia e Bizmarkut deri në fundin e Luftës së Dytë Botërore. Ky kapitull i ndarë në shtatë pjesë argumenton se si ideologjitë ndahen në ideologji përjashtuese (nazizmi, fashizmi, militarizmi) dhe universaliste (demokracitë dhe autokracitë). Pastaj se si këto ideologji bashkëpunojnë me kulturën si veçanti dhe civilizimin si përgjithësim apo më gjithëpërfshirës. Kandidati argumenton se si këto ndarje edhe kanë krijuar formacionet e koalicioneve që mund të funksionojnë në bazë të tri koncepteve dhe se si nacionalizmi i parapriu civilizimit dhe bashkimit trekonceptual. Po ashtu shpjegohet

nga perspektiva e tri koncepteve se si edhe u krijua vizioni i dy kampeve për të ardhmen pas Luftës së Dytë Botërore.

Kapitulli i katërt përfshinë periudhën e Luftës së Ftohtë. Kandidati për ta bërë më të elaborueshëm këtë periudhë e ka ndarë në dy pjesë të cilat janë të argumentuara nga perspektiva trekonceptuale. Pjesa e parë përfshinë periudhën e konsolidimit brenda kampeve deri me 1950 dhe pjesa e dytë përplasia jashtë kampeve apo periferike. Për të elaboruar këtë pjesë më mirë kandidati po ashtu e ka nxjerrë një formulë e cila tregon bashkëpunimin dhe përplasjen trekonceptuale paralele dhe jo paralele. Në këtë pjesë argumentohet edhe se si ku nuk ka gjetur zbatim trekonceptualiteti shtrirja ka qenë shumë e vështirë dhe edhe nëse ka ndodhur pushtimi, qeverisja ka qenë e pamundur si në rastin e Vietnamit. Kjo pjesë përfshin edhe shpjegimin e doktrinave të cilat bënë historinë si ajo e Stimsonit mbi mosnjohjen e pushtimeve, e Trumanit, Niksonit, Reganit dhe Leninit. Kjo pjesë e cila përmban njëmbëdhjetë pjesë me disa nënpjesë argumenton fuqishëm se si trekonceptete shpjegojnë dhe harmonizojnë apo bëjnë përplasjen e regjioneve trekonceptuale në paralele dhe periferi.

Kapitulli i pestë paraqet pjesën nga fundi i Luftës së Ftohtë e deri më sot, në këtë pjesë kandidati ka paraqitur përplasjen trekonceptuale në terma më të kuptueshëm dhe më transdisiplinare. Kjo pjesë përmban përplasjen dhe bashkëpunimin e plotë trekonceptual deri tek riformësimi i rendit global në forma regjionalistë trekonceptuale. Në këtë pjesë është përfshirë edhe zbatimi i normave ndërkombëtare në rastin e Kosovës, Krimesë dhe rastin e Detit të Kinës Jugore.

Konkluzionet janë paraqitur në pika të tjera të këtij raporti dhe gjithashtu përmban shtojcën me statistika të përpunuara nga indeksi i demokracisë të cilat plotësojnë argumentimin e përplasjeve trekonceptuale.

## **7. Kontributet kryesore shkencore të kandidatit**

Kandidati, Ma. Sc. Gurakuç Kuçi, duke pasur një temë e cila ka një trajtim komplementar trekonceptual, formë e re analitike dhe parashikuese ka kontribute shkencore të cilat në tërësi mund të kuptohen denjësisht vetëm nëse lexohet disertacioni në tërësi, megjithatë këtu do të përmendim disa kontribute.



Në marrëdhëniet ndërkombëtare ndikimi i ideologjisë dhe civilizimit nga studiuesit e kësaj fushe nuk shihen si koncepte që ndikojnë drejtpërdrejt e aq më pak si komplementare bashkë me gjeopolitikën. Mirëpo, nëse shohim argumentimin e kandidatit e kuptojmë që analizimi dhe parashikimi marrëdhënies ndërkombëtare pashmangshëm duhet të shihet nga shumë anë që të ketë saktësi. Kontributi kryesor i kandidatit është që arrin të argumentoj se si civilizimi, ideologjia dhe gjeopolitika janë tri koncepte që funksionojnë në formë paralele dhe jo-paralele për analizimin dhe parashikimin e zhvillimeve ndërkombëtare nga forma politike dhe juridike.

Kontribut tjetër nga kandidati është argumentimi nga ana juridike e disa rrethanave dhe ngjarjeve në arenën ndërkombëtare nëpërmjet trekonceptualitetit gjë që tregon se e drejta ndërkombëtare është një element që vepron në duart e fuqive të mëdha dhe nuk reagohet kur prek zonat trekonceptuale të njëri-tjetrit edhe nëse shkelet e drejta ndërkombëtare.

Kandidati gjithashtu me këtë temë ka arritur të ofrojë për shkencën një model të ndarjes së ideologjive me kritere si civilizimi, kultura, nacionalizmi e racizmi duke e bërë kështu ideologjinë si një proces komplementar me civilizimin dhe të dyja këto për ta ruajtur zonën e tyre bëhen komplementar me gjeopolitikën.

Ky lloj trekonceptualiteti tregon edhe format e shtrirjeve juridike të cilat janë zbatuar në zona të ndryshme trekonceptuale dhe si kontribut jep se pse një formë e caktuar juridike dhe të drejta të caktuara mund të funksionojnë në një zonë trekonceptuale dhe jo në një tjetër.

Kontribut tjetër i kandidatit është opsioni i bashkëpunimit dhe përplasjes duke pranuar qenësinë reale të zonave globale. Kjo mundëson që nëpërmjet analizës trekonceptuale të ofrohet një lloj analize dhe strategjie për fuqitë e mëdha se ku mund të bashkëpunojnë dhe të shmangin përplasjet për shkak të mos-komplementaritetit trekonceptual, shembull si në rastin e SHBA-së me Irakun apo Afganistanin.

## **8. Fusha shkencore në të cilën do të aplikohen rezultatet**

Disertacioni i kandidatit, Ma. Sc, Gurakuç Kuçi, ka një aplikueshmëri të gjerë përdorimi nga palë të tjera. Punimi i kandidatit është i punuar nga sfera e politikës ndërkombëtare dhe e së drejtës ndërkombëtare. Kandidati sipas nevojës ka përdorur katër nivelet e analizës së marrëdhënies ndërkombëtare (nivelelin shtetëror, rajonal, inter-rajonale dhe globale).

Ndërsa aplikueshmëria e disertacionit të z. Kuçi mund të përdoret në të gjitha sferat sociale, ekonomike dhe juridike në fushën ndërkombëtare si një temë që më shumë promovon gjetjen e modeleve të bashkëpunimit nëpërmjet analizave komplementare se sa përplasjen apo pushtimin.

#### **9. Hulumtime të mundshme në të ardhmen**

Kandidati këtë temë mund ta zgjerojë shumë më shumë duke pasur një analizë edhe më të thuktë, pasi në këtë disertacion universitar ekzistojnë limite dhe kritere. Nga ky disertacion mund të nxirren edhe shumë hulumtime të tjera duke e bërë temën më gjithëpërfshirëse bashkë me një shpjegim edhe nga teoria regjionaliste. Po ashtu hulumtimi nga perspektiva juridike mund të përdoret në analizimin e funksionimit të sistemeve juridike në shoqëri dhe zona të ndryshme të botës.

#### **10. Përfundim me propozim**

Disertacioni i kandidatit për doktor, Ma. Sc. Gurakuç Kuçi, është një temë e cila që nga hyrja, pjesa teorike, përmbajtja analitike dhe konkluzionet vazhdimisht merret me argumentimin e komplementaritetit të tri koncepteve. Duke pasur një qasje të tillë arrin në konkluzionin dhe vërtetimin e hipotezës e cila është cekur më lartë.

Kandidati në disertacion argumenton se përplasjet e fundit që po ndodhin kanë një qasje trekonceptuale dhe se zonat të cilat nuk kanë një civilo-centrizëm dhe qasje të tillë mund të jenë zona të luftës me zona tjera trekonceptuale të cilat duan ta shtrijnë Gjeopolitikën Periferike të tyre. Zonat e tilla rezitojnë në forma të ndryshme deri me metoda jo-ligjore sipas ligjit të luftës për të mbajtur larg sundimin dhe pushtimin. Këto zona pa trekonceptualitet as nuk mund të menaxhohen vet e as nuk mund të pranojnë dikë nga jashtë t'i menaxhojë, për pasojë modeli i kandidatit supozon se sundimi i një zonë sot mund të bëhet vetëm duke ofruar një model trekonceptual për atë zonë me një shtet bërthamë, si p.sh. Turqia për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, gjë që kjo mund të realizohet edhe me ndihmën e SHBA-së.

Disertacioni i kandidatit i plotëson kriteret e vëna nga Universiteti i Tetovës dhe Fakulteti Juridik për tu pranuar nga unë, Prof. Dr. Qebir Avziu, si mentor i tij dhe të vazhdoj procedurën e rregullt për mbrojtje.



Komisioni:

1. Prof. dr. Afrim Osmani, kryetar \_\_\_\_\_

2. Prof. dr. Bujar Ahmedi, anëtar \_\_\_\_\_

3. Prof. dr. Jusuf Zejneli, anëtar \_\_\_\_\_

4. Prof. dr. Fehari Ramadani, anëtar \_\_\_\_\_

5. Prof. dr. Qebir Avziu, mentor \_\_\_\_\_